

Në bazë të nenit 103, nenit 27 paragrafi 2 aline 8 dhe neni 148 të Ligjit për arsimin e lartë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.82/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.178/21) dhe Rregullores për kushtet, kriteriumet dhe rregullat e regjistrimit dhe studimit në ciklin e parë të studimeve në Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup, Drejtoria Rektoriale e Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup shpall,

K O N K U R S

për transferim të studentëve në ciklin e parë të studimeve në fakultetet dhe njësitë akademike të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup për vitin akademik 2025/2026

1. Transferimi i studentëve në ciklin e parë të studimeve realizohet në të gjithë fakultetet/programet studimore të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, edhe atë:

1.1 Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës;

- Arkitekturë dhe dizajn (180 EKTC)
- Ndërtimtari – konstruktive (180 EKTC)

1.2 Fakulteti i Shkencave Informatike;

- Informatikë (240 EKTC)
- Programim i aplikuar (180 EKTC)
- Informatikë- mësimdhënie (240 EKTC)
- Shkenca kompjuterike dhe inxhinierike (240 EKTC)

1.3 Fakulteti i Shkencave Teknike;

- Mekatronikë (180 EKTC)
- Inxhinieri e transportit dhe komunikacionit (240 EKTC)
- Elektronenergjetike dhe burimet e ripërtirshme të energjisë (240 EKTC)
- Dizajni i qëndrueshëm në inxhinierinë makinerike (240 EKTC)
- Menaxhment industrial (240 EKTC)
- Inxhinieria për mbrojtje të ambientit të punës dhe jetesës
- Mbrojtje në punë

1.4 Fakulteti i Shkencave Teknologjike;

- Teknologjia ushqimore (240 EKTC)
- Dizajni i prodhimeve kimike dhe procesit (240 EKTC)

1.5 Fakulteti i Shkencave Sociale;

- Media dhe komunikim ndërkulturor (240 EKTC)
- Sport dhe shkencat e sportit (240 EKTC)
- Ekonomi e zbatuar dhe ndërmarrësi (240 EKTC)

1.6 Fakulteti Ekonomik;

- Marketing dhe menaxhment (240 EKTC)

1.7 Fakulteti i Shkencave Humane;

- Gjuhë dhe Letërsi Gjermane (240 EKTC)

2. Kushtet e transferimit të studentëve në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup:

A. Studentë me status të studentit të Universitetit „Nënë Tereza“ në Shkup:

- A.1.** Të drejtë për transferim brenda njësive akademike të Universitetit “Nënë Tereza” kanë të gjithë studentët që kanë indeks të UNT-së, në përputhje me kushtet dhe kriteret aktuale të përcaktuara në Rregulloren për studime në ciklin e parë të studimeve në Universitetin “Nënë Tereza” – Shkup.
- A.2.** Transferimi i studimeve realizohet vetëm në programet studimore aktive të fakulteteve amë. Për transferimin në semestrin e 4-të dhe të 6-të, studentët do të njoftohen më tej pas shqyrtimit të dokumentacionit nga ana e Komisionit për transferim të njësisë, dhe në përputhje me vendet e lira.
- A.3.** Pas realizimit të transferimit të kredive ECTS, studenti gjatë regjistrimit në programin e transferuar është i detyruar të çregjistrojë studimet nga programi nga i cili është transferuar, në përputhje me natyrën e programit studimor dhe mënyrën e studimeve.

B. Studentë nga institucione të tjera të arsimit të lartë:

B.1. Të drejtë për transferim nga institucionet e tjera të arsimit të lartë në njësitë akademike të Universitetit “Nënë Tereza” kanë të gjithë studentët që:

- Kanë përfunduar së paku një vit akademik në universitetin nga i cili vijnë;
- Kanë të akumuluar ECTS kredite që mund të transferohen në programin studimor ku aplikon studentin, pas shqyrtimit të dokumentacionit nga Komisioni për transferim të njësisë dhe në përputhje me vendet e lira;
- Kanë status aktiv të studentit në vitin akademik **2025/2026**.

B.2. Studenti mund të transferohet në fakultetin dhe programin studimor të njëjtë ose në drejtime të ngjashme në fakultetet dhe programet studimore të UNT-së. Ngjashmërinë e programeve studimore e përcakton Komisioni i fakultetit për transferim.

3. Afatet e paraqitjes për transferimin dhe regjistrim në UNT:

Kandidatët që transferohen në Universitetin “Nënë Tereza” regjistrohen në kuotën e studimeve me vetëfinancim, në përputhje me tarifat aktuale të studimit për programet studimore në vitin akademik 2025/2026.

Afatet për realizimin e transferimit:

- **Paraqitja e kandidatëve (aplikimi): 13-16. 01.2026**
- **Sjellja e vendimeve përfundimtare: 20.01.2026**
- **Regjistrimi i kandidatëve: në varësi të pranimit ose jo të aktvendimeve nga MASH)**

4. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- **Fletëparaqitja për aplikim** (detyrimisht të shënohet adresa e saktë e e-mailit dhe numri aktiv i telefonit);
- **Certifikata origjinale e notave dhe indeksi** nga universiteti amë;
- **Vërtetim se kandidati është student aktiv** në vitin akademik 2025/2026;
- **Dëshmi për akreditimin e njësisë akademike** (për shtetasit e huaj). Gjatë aplikimit, kandidati detyrimisht duhet të paraqesë dëshmi për akreditimin e institucionit të arsimit të lartë, përkatësisht të fakultetit apo programit studimor nga i cili transferohet;
- **Kopje të dëftesave të arsimit të mesëm dhe kopje të diplomës së arsimit të mesëm të përfunduar**, të noterizuara;
- **Dëshmi për nostrifikimin e arsimit të mesëm** nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e RMV-së (për arsimin e mesëm të përfunduar jashtë RMV-së dhe për shtetasit e huaj);

- **Certifikatë e lindjes dhe dëshmi për shtetësi** (certifikatë ose aktvendim);
- **Dëshmi për pagesën e taksës së transferit:** 850 denarë, të paguara në xhiro-llogarinë e Universitetit, në emër të taksave administrative.

VËREJTJE: Kandidatët të cilët pranohen (pas shpalljes dhe nxjerrjes së Vendimit përfundimtar) janë të obliguar që brenda afatit të caktuar të realizojnë regjistrimin e studimeve. Në të kundërtën, Vendimi për transferim do të konsiderohet i pavlefshëm.

5. Gjatë regjistrimit kandidatët duhet të dorëzojnë:

1. Fletëparaqitje për regjistrim
2. Fletëregjistrimin e studimeve nga fakulteti i cili transferohet
3. Fotografi (dy fotografi 6 x 9 dhe dy fotografi 4 x 5 cm)
4. Dëftesat origjinale të shkollimit të mesëm dhe Diplomën origjinale të shkollës së mesme të kryer,
5. Vërtetim për pagesën e mjeteve dhe atë:
 - **800 denarë** në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të dhënies së Indeksit;
 - **750 denarë** në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të veprimtarive informative, sportive, kulturore të studentëve të Universitetit;
 - **100 denarë** në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të Parlamentit Studentor
 - **4.000 denarë** në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të shpenzimeve për realizimin e transferim;
 - Pagesën për semestër, në vlerë prej **12.300 denarë**.

Të gjitha pagesat e lartpërmendura duhet të kryhen në xhiro-llogarinë e Universitetit në këtë mënyrë:

- Në “emër të marrësit” (“назив на примачот”) – Universiteti “Nënë Tereza” – Shkup
- Në “banka e marrësit” (“банка на примач”) – Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Në “llogaria” (“сметка”) 100000000063095,
- Në “llogaria e shfrytëzuesit buxhetor- subjekti shfrytëzues” (сметка на буџетски корисник единка корисник) - 1600162677 788 15
- në “shifra dhe programi i të hyrave” (“Приходна шифра”) 723012,
- Në “thirrja në numrin” (“програма”) 45.

Të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e tyre për aplikim t’i dorëzojnë personalisht në hapësirat e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup. Pranimi i dokumenteve do të bëhet në **zyrën nr. 210**.

Konkursi do të shpallet në faqen e internetit:: <http://www.unt.edu.mk>